



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

Njoftim për shtyp

Mbi vendimin e Komisionit teKonkurrencës “Për ndalimin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Ultra Motors” sh.p.k. dhe vendosje gjobe ndaj tyre për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja”

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij të datës 20.09.2010 ka shqyrtuar çeshtjen me objekt ekzistencia ose jo e marrëveshjes në oferta ndërmjet ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Huynundai Auto Albania” sh.p.k, “Ultra Motors” sh.p.k dhe “Noti” sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja.

Autoriteti i Konkurrencës në bazë të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(Ligji) ka zbatuar procedurat e monitorimit dhe më pas te hetimit paraprak në tregun e prokurimeve publike të automjeteve të reja. Nga evidencat e grumbulluara gjate këtij procesi, në formë elektronike dhe shkresore, jane konstatuar gjurme të bashkëpunimit për pjesëmarrje në prokurimet publike midis 4 ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k, “Ultra motors” sh.p.k, “Noti” sh.p.k dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k, e cila mund të përbënte një marrëveshje të ndaluar në prokurime ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës.

Për sa më lart, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 135, datë 21.12.2009 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja” ndaj ndërmarrjeve “Classic” sh.p.k; “Ultra motors” sh.p.k; “Noti” sh.p.k; dhe “Hyundai Auto Albania” sh.p.k.Gjate realizimit të procedurës hetimore, inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës kanë administruar një sërë evidencash shkresore dhe elektronike(nga kompjuterat) të bashkëpunimit mes katër ndërmarrjeve, çka provonte se ato kishin eleminuar konkurrencën mes tyre në tenderat publikë për automjete të reja, duke mbajtur për disa vite një marrëveshje të fshehtë për bashkëpunim në tendera.

Në trajtimin e këtij rasti Autoriteti i Konkurrencës është mbështetur në metodologjinë e OECD “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” dhe u konstatua se skemat kryesore të bashkëpunimit mes tyre përfshijnë nënkontraktimet, ofertë të mbuluar, rotacionit

në ofertat fituese si dhe shenja të ngjashme apo të njëjtanë dokumentet e dorëzuara nga këto ndërmarrje në Autoritetet Kontraktore.

Në përfundim të hetimeve, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore me ndërmarrjet objekt-hetimi ku këto të fundit paraqiten pretendimet e tyre në lidhje me reportin hetimor të përgatitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës, me shumicë votash, vendosi ndalimin e marrëveshjes në oferta në tregun e prokurimeve të automjeteve të reja midis ndërmarrjeve nën hetim dhe për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar në oferta si shkelje e nenit 4 të Ligjit vendosi:

- të gjobisë ndërmarrjen “Classic” sh.p.k, në shumën 25,712,000 Lekë;
- të gjobisë ndërmarrjen “Hyundai Auto Albania” sh.p.k në shumën 5,383,000 Lekë;
- të gjobisë ndërmarrjen “Ultra motors” sh.p.k, në shumën 1,517,000 Lekë;
- të gjobisë ndërmarrjen “Noti” sh.p.k, në shumën 2,994,000 Lekë;

Për më shumë informacion, gjeni të publikuar të plotë vendimin e Komisionit të Konkurrencës dhe mendimin e pakicës në faqet zyrtare të internetit të Autoritetit të Konkurrencës www.caa.gov.al në seksionin “Vendime”.